



PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2011

I DETYRUAR

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI **A**

Lënda: Letërsi dhe Gjuhë shqipe

Shkolla e mesme pedagogjike

Udhëzime të përgjithshme:

- Testi përbëhet nga dy pjesë.
- Testi përmban një total prej 50 pikësh.
- Testi ka 25 pyetje. 13 me zgjedhje dhe 12 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigja e saktë vlerësohet me 1 pikë.
- Për pyetjet me zhvillim përgjigjet konsiderohen orientuese dhe në skemë parashikohen variantet e mundësive të përgjigjeve të nxënësve.
- Vlerësimi i pyetjes *ese* do të bëhet duke pasur parasysh rubrikat në tabelën e vendosur në fund të pyetjes dhe që është posaçërisht për vlerësuesit e testit.
- Saktësia gjuhësore ndikon negativisht në vlerësimin e nxënësit, në ato raste, kur ka përsëritje të theksuar gabimesh ose gabime të cilat prishin në mënyrë të vazhdueshme kuptimin e shprehjes.

PJESA I**Gjuhë shqipe**

Pyetja 1	A	1 pikë
Pyetja 2	A	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	D	1 pikë
Pyetja 5	C	1 pikë
Pyetja 6	B	1 pikë

Pyetja 7 4 pikë

1 pikë	që	përemër (lidhor)
1 pikë	pranë	parafjalë
1 pikë	vetëm	pjesëz
1 pikë	fare	ndajfolje

Pyetja 8 3 pikë

1 pikë	koha e foljes:	më se e kryer
1 pikë	lloji i kallëzuesit:	i thjeshtë (foljor)
1 pikë	forma e foljes:	të pushoja

Pyetja 9 1 pikë

1 pikë	rasa: i - dhanore
---------------	-------------------

Pyetja 10 3 pikë


1 pikë	i ujshëm:	përcaktor
1 pikë	një avull:	kryefjalë
1 pikë	që:	kryefjalë

Pyetja 11 3 pikë

1 pikë	rrethanori:	aty – këtu
1 pikë	lloji:	vendi
1 pikë	shprehur me:	ndajfolje (lokucion ndajfoljor)

OSE

1 pikë	rrethanori:	ngadalë
1 pikë	lloji:	mënyre
1 pikë	shprehur me:	ndajfolje

Pyetja 12 3 pikë**2 pikë** Lloji i fjalive të nënrenditura: përcaktore dhe lejore**1 pikë** Skema e fjalisë së përbërë:**Shënim:**

Nxënësi do të marrë një pikë edhe nëse e ka dhënë saktë skemën e fjalisë, por nuk ka plotësuar kuadratet e saj.

PJESA II**Balzak****Evgjeni Grande**

Pyetja 13	A	1 pikë
Pyetja 14	C	1 pikë
Pyetja 15	D	1 pikë
Pyetja 16	B	1 pikë
Pyetja 17	C	1 pikë
Pyetja 18	B	1 pikë
Pyetja 19	C	1 pikë

Pyetja 20 **2 pikë****Model përgjigjeje**

Zakone që dëshmojnë jetën që Evgjenia bën:

- *Zjarrin e ndez vetëm ato ditë që e lejonte i ati*
- *Vazhdon të vishet si e ëma.*
- *Shtëpia e saj, pa diell, pa ngrohtësi, e zymtë, e zbrazët.*
- *Në atë zemër nisi të rëndonte pesha e interesit dhe e llogarive.*
- *Zjarrin e shuan sipas programit të ditëve të çupërisë së saj.*

2 pikë Nëse gjen dy zakone të vjetra, që tregojnë jetën që ajo bën.

OSE

1 pikë Nëse gjen vetëm një zakon të vjetër, që tregon jetën që ajo bën.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë kur citon momente nga fragmenti ose kur perifrason.

Pyetja 21 **3 pikë****Model përgjigjeje**

- Ndryshimi më i madh midis Evgjenisë dhe të atit qëndron se Evgjenia ka shpirt fisnik, bujar, ndihmon të tjerët dhe kryen shumë vepra bamirësie.
- Tipari dallues i mjedisit në të cilin jeton Evgjenia është: provincializmi, të marrurit me jetën të tjerëve, thashethemet, jeta e mbyllur.
- Evgjenia i përkushtohet shumë bamirësisë, pasi e ka në natyrën e saj të ndihmojë të tjerët.

OSE

- Evgjenisë pasuria nuk i solli asgjë të mirë në jetë, asaj s'i bën më përshtypje ajo, nuk është qëllimi i jetës së saj, ndaj e përdor për qëllime fisnike.

OSE

- Evgjenia i është përkushtuar bamirësisë për të harruar dramën e saj, humbjen e dashurisë. Gjen ngushëllim në veprën që bë.

OSE

- Ai ar i solli shumë trishtim në jetë, ndaj është më mirë ta përdorë të paktën në mënyrën e duhur.

1 pikë Nëse tregon ku qëndron ndryshimi midis Evgjenisë dhe të atit.

1 pikë Nëse tregon një tipar dallues të mjedisit ku jeton Evgjenia.

1 pikë Nëse shpjegon pse Evgjenia i përkushtohet kaq shumë bamirësisë.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë shpreh mendime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 22 **2 pikë****Model përgjigjeje**

a) Figura e stilistikës: epiteti

b) Pjesa e ligjëratës: mbiemri

1 pikë Nëse gjen figurën e stilistikës.**1 pikë** Nëse gjen pjesën e ligjëratës.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.**Pyetja 23** **3 pikë**

Drama e madhe e jetës së Evgjëni Grandesë qëndron në faktin se ajo humbi gjithçka në këtë jetë: dashurinë dhe të qenit nënë. Mjedisi i shkatërroi dëshirat dhe ëndrrat e saj. Në fillim ajo humbi dashurinë e jetës, më pas, martesën me interes të shkatërroi përfundimisht ëndrrat e saj. Ajo mbetet e vetme në këtë jetë, pa askënd pranë që ta kuptojë dhe dojë, si grua, nënë dhe bashkëshorte.

Ilustrimi: Kjo është historia e kësaj gruaje, e cila, ndonëse jetoi në këtë botë, nuk ish për këtë botë. Ajo që lindur për të qenë grua e shkëlqyeshme dhe nënë; dhe tashti s'ka as burrë, as familje, as fëmijë.

Vajza buzëplatur dhe e vetmuar,

Zoti e rrethoi robëreshën e tij me thasë plot me florinj.

2 pikë Nëse shpjegon në mënyrë të plotë dramën e jetës së Evgjëni Grandesë.
OSE**1 pikë** Nëse shpjegon pjesërisht dramën e jetës së Evgjëni Grandesë.**DHE****1 pikë** Nëse i mbështet mendimet me ilustrime nga fragmenti.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë shpreh mendime që nuk i përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit i gjykon të sakta.

Pyetja 24 **2 pikë****Përgjigje e lirë**

Nxënësi duhet të tregojë ndjesinë që i shkaktoi ky fragment (dhimbje, keqardhje, etj).

Nxënësi shpreh një mendim të parë që i lindi sapo e mbaroi së lexuari, por që lidhet me thelbin e fragmentit ose romanit.

1 pikë Nëse tregon ndjesinë që i lindi nga leximi i fragmentit.**1 pikë** Nëse shkruan mendimin e parë që i lindi kur e përfundoi.**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

